

<p style="text-align: center;"><b>DHOMA E POSAÇME E GJYKATËS SUPREME TË KOSOVËS PËR ÇËSHTJE QË LIDHEN ME AGJENCINË KOSOVARE TË PRIVATIZIMIT</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>SPECIAL CHAMBER OF THE SUPREME COURT OF KOSOVO ON PRIVATIZATION AGENCY OF KOSOVO RELATED MATTERS</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>POSEBNA KOMORA VRHOVNOG SUDA KOSOVA ZA PITANJA KOJA SE ODNOSE NA KOSOVSKU AGENCIJU ZA PRIVATIZACIJU</b></p>
---	--	---

12 dhjetor 2012

**SCEL – 06 – 0002 - C0021**

*Ankuesi*

**Z.P.D., XX**

Kundër

*Të paditurës*

**Agjencia Kosovare e Privatizimit,  
Irir Konushevci 8, Prishtinë**

Kolegji i specializuar i përbërë nga Alfred Graf von Keyserlingk, Gjyqtar kryesues, Shkelzen Sylaj dhe Qerim Fazliji, Gjyqtarë, lëshon këtë

## **A K T V E N D I M**

**Ankesa e Z.P.D.  
hidhet poshtë si e papranueshme.**

### **Rrethanat faktike dhe procedurale**

Më 11 nëntor 2011, Ankuesja ka parashtruar ankesë në Dhomën e Posaçme në të cilën ka kërkuar përfshirjen në listën e punëtorëve me të drejtë legjitime për të marrë një pjesë nga të ardhurat e privatizimit të NSH-së XX, Prishtinë (tutje në tekst NSH).

Ankuesja thekson se ajo ishte punësuar në NSH që nga 16.08.1982 dhe punësimi i saj nuk ishte ndërprerë. Ankuesja kërkon që ankesa e saj të miratohet edhe pse ajo nuk është ankuar kundër listës së përkohshme të

publikuar nga AKP-ja, sepse ajo kishte marrë vesh për listën përfundimtare dhe procesin e privatizimit, vetëm pasi kishte skaduar afati. Ankuesja deklaroi se ajo nuk ka mundësi të përcjellë shtypin sepse është person i zhvendosur, pa të ardhura, dhe me një vajzë të sëmurë.

Ankuesja ka bashkëmbyllur kopjen e librezës së saj të punës, dokumentit të identifikimit dhe certifikatave mjekësore.

Në vërejtjet me shkrim ndaj ankesës më 14 dhjetor 2011, Agjencia Kosovare e Privatizimit (tutje AKP) ka deklaruar se ankesa duhet të refuzohet si e papranueshme për shkak se afati i fundit për paraqitjen e ankesave në Dhomën e Posaçme (Neni 10.6 i RREG së UNMIK-ut 2003/13) ka qenë 22 maji 2006, ndërsa ankesa është paraqitur më 11 nëntor 2011, pesë vite pas skadimit të afatit.

Në përgjigjen e 13 gushtit 2012, Ankuesja deklaroi se ajo është e vetëdijshme se ankesa e saj është e vonuar, por gjatë kësaj kohe ajo ka qenë në spital në Serbi me vajzën e saj, ajo gjithashtu ka paraqitur ankesë më 14 shkurt 2007, kur e kishte kuptuar se NSH-ja ishte privatizuar dhe që emri i saj nuk ishte në listën përfundimtare. Ajo pohon se ajo ishte punësuar si sekretare që nga viti 1982 deri në qershor 1999, kur asaj i ishte dashur ta linte vendin e punës për shkak të situatës së mirënjohur të sigurisë. Ajo deklaroi se ajo i plotëson të gjitha kriteret ligjore meqë punësimi i saj nuk ishte ndërprerë.

### **Arsyetimet ligjore**

Ankesa është e papranueshme, sepse nuk është paraqitur me kohë. Afati i fundit për paraqitjen e ankesave ka qenë 22 maji 2006.

Neni 10.6 (a) i Rregullores së UNMIK-ut 2003/13 i plotësuar me Rregulloren 2004/45 mbi transformimin e së drejtës së përdorimit të pronës së patundshme në pronësi shoqërore, parasheh një afat kohor prej

20 ditësh, pas publikimit nga Agjencia të listës përfundimtare në media, për kundërshtimin e listës përfundimtare të punëtorëve me të drejtë

legjitime për 20%-shin e të ardhurave korporative nga privatizimi i NSH-së.

Ky afat kohor ligjor është detyrues si për gjykatën ashtu dhe për palët në procedurë, nuk mund të ndryshohet. Në rast se ankesa që kundërshton listën përfundimtare të punëtorëve është bërë brenda këtij afati, ajo konsiderohet që është bërë me kohë dhe shqyrtimi i meritave të saj mund të merret parasysh. Në të kundërtën, kur ankesa bëhet pas afatit ligjor ajo është jashtë afatit, pavarësisht nëse Ankuesja e ka ditur apo ka mundur të dinte për publikimin e listës përfundimtare.

Bazuar në Nenin 117 të LPK-së, e zbatueshme në bazë të Nenit 70.3 të UA-së së UNMIK-ut 2008/6, Gjykata mund t'i mundësojë një pale të ndërmarrë veprim procedural, i cili përndryshe do ta kishte humbur të drejtën e lartpërmendur, në rast se pala paraqet kërkesë për kthimin në pozitën e mëparshme. Por në bazë të nenit 118, paragrafit 3, të LPK-së dhe pas skadimit të afatit prej 3 muajve nga data e mosrespektimit, kthimi në pozitën e mëparshme nuk mund të kërkohet ligjërisht.

Kjo është e vlefshme për këtë ankesë dhe do të ishte njëjtë e vlefshme për ankesën e mëhershme të 14 shkurtit 2007.

### **Shpenzimet**

Gjykata nuk i shqipton shpenzime paditësit meqë Presidiumi i Gjykatës deri më tani nuk e ka nxjerrë planin me shkrim i cili miratohet nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës (Neni 57 Paragrafi 2 i Ligjit të Dhomës së Posaçme). Kjo do të thotë se deri tani nuk ka bazë të mjaftueshme ligjore për shqiptimin e shpenzimeve.

### **Këshilla ligjore**

Kundër këtij aktvendimi mund të parashtrahet Apel brenda 21 ditësh tek Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme. Apeli duhet t'i dërgohet edhe palëve të tjera dhe të dorëzohet tek Kolegji Gjyqësor **nga Ankuesi** brenda 21 ditësh. Ankuesi duhet të dorëzojë tek Kolegji i Apelit dëshminë se e ka dërguar Apelin edhe tek palët tjera.

Afati i paraparë fillon në mesnatën e asaj dite kur Apeluesit i është dërguar aktvendimi me shkrim.

**Kolegji i Apelit e refuzon apelin si të papranueshëm nëse Ankuesi nuk e parashtron atë brenda afatit të paraparë.**

E paditura mund të parashtrojë përgjigje tek Kolegji i Apelit brenda 21 ditëve nga data kur i është dërguar apeli, duke e dorëzuar përgjigjen edhe tek ankuesi dhe tek palët tjera.

Ankuesi pastaj i ka 21 ditë afat pasi që t'i dërgohet përgjigja në apelin e tij, për ta dorëzuar përgjigjen e vet tek Kolegji i Apelit dhe për ta dërguar atë tek pala tjetër. Pala tjetër pastaj i ka 21 ditë afat pasi që t'i dërgohet përgjigja e ankuesit që të dorëzojë kundërpërgjigjen e tij tek Ankuesi dhe tek Kolegji i Apelit.

Alfred Graf von Keyserlingk, Gjyqtar kryesues